REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Nr. 1815/4 prot.

Tiranë, më 12. 10.2026

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. 1628 prot.

Tiranë, më 12. 10.2026

# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

## PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E TASK FORCËS PËR LUFTËN KUNDËR PIRATERISË DIGJITALE AUDIOVIZIVE

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional, shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve përkatëse,

Në mbështetje të:

- ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike";
- ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**, përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Armela Krasniqi dhe **Prokuroria e Përgjithshme**, përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, z. Olsian Çela, në vijim referuar si "Palët,

bien dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi:

## Neni 1
## Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim vendosjen dhe institucionalizimin e një mekanizmi të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe Prokurorisë së Përgjithshme, me synim parandalimin, evidentimin, dokumentimin dhe ndjekjen e rasteve të piraterisë digjitale audiovizive, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e tyre, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të secilit institucion dhe me legjislacionin në fuqi.

## Neni 2
## Parimet e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të bazohet në parimet e:
   a) ligjshmërisë;
   b) respektimit të pavarësisë dhe kompetencave të secilit institucion;
   c) shkëmbimin e ligjshëm, të sigurt dhe në kohë të informacionit;
   ç) konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave;
   d) respektimin e kërkesave të legjislacionit procedural penal dhe sekretit hetimor.
2. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk do të interpretohet si transferim, delegim ose kufizim i kompetencave ligjore të njërës palë në favor të palës tjetër.

## Neni 3
## Fushat e bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë, sipas kompetencave të tyre, në fushat e mëposhtme:

a) identifikimin dhe dokumentimin e rasteve të piraterisë digjitale audiovizive;
b) hetimin dhe ndjekjen penale në rast të shkeljes së ligjit, në përputhje me ligjin penal;
c) shkëmbimin e informacionit mbi platformat, subjektet, domenet, adresat IP dhe mënyrat e shpërndarjes së paligjshme të përmbajtjeve audiovizive, në funksion të hetimeve;
ç) bashkëpunimin për sigurimin dhe ruajtjen e informacionit elektronik, në përputhje me kërkesat e legjislacionit;
d) zhvillimin e praktikave të unifikuara për dokumentimin dhe referimin e rasteve;
dh) shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave profesionale;
e) organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta;
ë) evidentimin e problematikave ligjore dhe institucionale dhe formulimin e propozimeve për përmirësimin e kuadrit rregullator.

## Neni 4
## Të drejtat dhe detyrimet e AMA-s

AMA angazhohet për sa më poshtë:

a) të identifikojë dhe dokumentojë, në kuadër të kompetencave të saj, rastet e dyshuara të piraterisë digjitale audiovizive dhe shkeljes së të drejtave të transmetimit për të cilat konstatohen të dhëna ose rrethana që mund të tregojnë elemente të një vepre penale;

b) të kallëzojë pranë prokurorisë kompetente të juridiksionit të përgjithshëm materialet dhe informacionin që, bazuar në verifikimet e kryera, mund të tregojnë elemente të veprave penale;

c) të vendos në dispozicion, sipas kërkesës së Prokurorisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, informacionin teknik dhe administrativ që disponon;

ç) të mundësojë, sipas kompetencave të saj, informacion mbi:
- platformat digjitale;
- domenet dhe adresat IP;
- mënyrën e transmetimit ose shpërndarjes së përmbajtjes;
- subjektet e identifikuara;
- të dhënat dhe dokumentacionin e mbledhur gjatë monitorimit.

d) të bashkëpunojë për dokumentimin dhe ruajtjen e të dhënave elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale;

dh) të caktojë një pikë kontakti institucionale për komunikimin me Prokurorinë;

e) të marrë pjesë në takime teknike ose profesionale të organizuara në kuadër të këtij Memorandumi;

ë) të informojë Prokurorinë, në masën e lejuar nga ligji, për zhvillime, metoda ose forma të reja të piraterisë digjitale audiovizive.

## Neni 5
## Të drejtat dhe detyrimet e Prokurorisë

Prokuroria angazhohet për sa më poshtë:

a) të vlerësojë kallëzimet dhe ushtrojë ndjekjen penale me efikasitet dhe pavarësi, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore;

b) të kërkojë nga AMA, kur është e nevojshme, informacionin, dokumentacionin ose të dhënat shtesë që mund të jenë të nevojshme për vlerësimin dhe hetimin e plotë dhe të gjithëanshëm;

c) të bashkëpunojë me AMA-n për përcaktimin e praktikave të përshtatshme për dokumentimin dhe referimin e rasteve të piraterisë digjitale audiovizive;

ç) në përputhje me legjislacionin dhe pa cenuar sekretin hetimor, të informojë AMA-n për problematika të përgjithshme të konstatuara gjatë trajtimit të rasteve që lidhen me objektin e këtij Memorandumi;

d) të caktojë një pikë kontakti institucionale për komunikimin dhe bashkëpunimin me AMA-n;
dh) të mundësojë, sipas kuadrit ligjor dhe institucional, shkëmbimin e praktikave profesionale dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta trajnuese;
e) të bashkëpunon me AMA-n për evidentimin e problematikave të kuadrit ligjor dhe institucional që lidhen me luftën kundër piraterisë digjitale audiovizive.

## Neni 6
## Procedura e referimit dhe trajtimit të rasteve

1. AMA, pas identifikimit dhe verifikimit të një rasti të dyshuar të piraterisë digjitale audiovizive, përgatit dokumentacionin përkatës dhe, kur vlerëson se ekzistojnë të dhëna që mund të tregojnë elemente të një vepre penale, bën kallëzim pranë strukturës kompetente të prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.
2. Kallëzimi përmban, sipas rastit:
   a) përshkrimin e faktit dhe rrethanave të konstatuara;
   b) të dhënat mbi subjektin ose subjektet e identifikuara;
   c) të dhënat teknike të disponueshme që mundësojnë identifikimin dhe verifikimin e burimit dhe të përmbajtjes së konstatuar, përfshirë, sipas rastit, datën dhe orën e konstatimit, URL-në, domenin, adresën IP, kur disponohet, si dhe mënyrën e evidentimit të përmbajtjes;
   ç) të dhënat mbi përmbajtjen audiovizive të shpërndarë në mënyrë të dyshuar si të paligjshme;
   d) dokumentacionin, të dhënat dhe materialet e mbledhura nga AMA në ushtrim të kompetencave të saj ligjore;
   dh) çdo informacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm për vlerësimin e rastit.
3. Kallëzimi i një rasti nga AMA nuk paragjykon vlerësimin juridik të faktit, regjistrimin ose jo të procedimit penal, kualifikimin juridik të veprës apo çdo vendimmarrje tjetër procedurale të prokurorit kompetent.
4. Veprimet e mëtejshme procedurale kryhen nga organet kompetente të ndjekjes penale në përputhje me legjislacionin në fuqi. AMA nuk kryen veprime që i përkasin ekskluzivisht organeve të ndjekjes penale dhe nuk ndërhyn në hetimin penal.
5. Çdo kërkesë për informacion ose dokumentacion shtesë nga Prokuroria trajtohet nga AMA në përputhje me kompetencat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni.

## Neni 7
## Shkëmbimi i informacionit

1. Palët shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi, në përputhje me kompetencat ligjore të secilës palë.
2. Shkëmbimi i informacionit mund të realizohet në formë shkresore ose elektronike, nëpërmjet pikave të kontaktit të përcaktuara nga palët.

3. Informacioni që lidhet me hetime konkrete, sekretin hetimor, të dhënat personale ose informacionin e mbrojtur trajtohet në përputhje me legjislacionin përkatës.
4. Informacioni i marrë nga njëra palë nuk mund t'u përcillet palëve të treta pa autorizimin e palës që e ka vënë në dispozicion, përveç rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji.

**Neni 8**
**Pikat e kontaktit**

1. Secila palë cakton një pikë kontakti dhe një zëvendësues për komunikimin institucional në kuadër të këtij Memorandumi.
2. Pikat e kontaktit kanë për detyrë:
   a) të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit;
   b) të përcjellin kërkesat institucionale;
   c) të koordinojnë takimet teknike;
   ç) të ndjekin komunikimin institucional lidhur me materialet e kallëzuara;
   d) të propozojnë çështje për shqyrtim të përbashkët.
3. Përcaktimi i pikave të kontaktit nuk cenon kompetencat e organeve dhe strukturave të tjera të secilës palë.
4. Në dhe për zbatim të këtij memorandumi, personat e kontaktit do të jenë:

- Për Prokurorinë e Përgjithshme : _____ ;
- Për AMA-n: _____;

**Neni 9**
**Takimet dhe bashkëpunimi profesional**

Palët mund të zhvillojnë takime periodike ose të jashtëzakonshme për:

a) diskutimin e problematikave të përgjithshme të evidentuara nga rastet e referuara, pa cenuar pavarësinë e vendimmarrjes së prokurorit dhe respektimin e sekretit hetimor;
b) shkëmbimin e praktikave;
c) identifikimin e formave të reja të piraterisë digjitale;
d) vlerësimin e nevojave për ndryshime ligjore;
e) organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve profesionale.

**Neni 10**
**Raportimi dhe vlerësimi i bashkëpunimit**

1. AMA dhe Prokuroria, brenda kompetencave të tyre, mund të kryejnë periodikisht një vlerësim të bashkëpunimit të realizuar në kuadër të këtij Memorandumi. Ky vlerësim nuk përfshin apo nënkupton kontrollin ose vlerësimin e vendimmarrjes procedurale të prokurorit në çështje konkrete.
1. Vlerësimi mund të përfshijë:

- numrin dhe natyrën e rasteve të referuara;
- problematikat e identifikuara;
- nevojat për shkëmbim të mëtejshëm informacioni;
- nevojat për trajnime;
- propozime për përmirësimin e mekanizmave të bashkëpunimit.

2. Të dhënat që lidhen me hetime konkrete trajtohen në përputhje me rregullat për sekretin hetimor dhe konfidencialitetin.

**Neni 11**
**Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti**

1. Palët angazhohen të trajtojnë dhe përpunojnë çdo të dhënë personale, informacion konfidencial ose informacion të mbrojtur të shkëmbyer në kuadër të këtij Memorandumi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Çdo palë merr masat e nevojshme për parandalimin e aksesit, përdorimit, kopjimit ose shpërndarjes së paautorizuar të informacionit.

**Neni 12**
**Dispozita përfundimtare**

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të gjitha palët dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar.
2. Palët angazhohen të zbatojnë me përparësi detyrimet e përcaktuara në këtë Memorandum dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për përmbushjen e qëllimit të tij.
3. Ndryshimet ose shtesat në këtë Memorandum bëhen me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.
4. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.

**PALËT**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**KRYETAR**

**ARMELA KRASNIQI**

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**PROKUROR I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**